



Universiteti i Prizrenit Univerziteti Prizren Prizren Universiteti "UKSHIN HOTI" F. i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	
Pranuar me dt.	14.02.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
507	01-17

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"

UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT DEKANATI

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Prizren, më 14.02.2019

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 76 paragrafi 1 alineja 1.9 të Statutit të Universitetit sipas Nr. 04-V-621 dt. 30 maj 2013, dhe në zbatim të procedurave të konkursit të datës 28.01.2019 në lidhje me miratimin e raportit të Komisionit të vlerësimit e personelit të angazhuar për vitin akademik 2018/19 në semestrin veror, Këshilli i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, vendosi dhe nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Miratohet** njëzëri propozimi i Komisionit për vlerësimin e kandidatëve të paraqitur në konkursin 01-19/A për personel akademik me honorar për semestrin veror të vitit akademik 2018/19 në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit.
- II. Lista e personelit akademik me honorar në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit për semestrin veror të vitit akademik 2018/19 është si në vijim:

a). Mësimdhënësit

- **Msc. Laura Naka, Ligjëruese**, Mësimdhënëse në lëndën Gjuhë Angleze.
- **Msc. Amantina Pervizaj, PhD candidate**, Mësimdhënëse për lëndën Gjuhë Angleze II.
- **Prof. Asoc. Dr. Musaj Paçarizi**, Mësimdhënëse për lëndën Kimia e Përgjithshme dhe Organike 2.
- **Prof. Dr. Hysen Bytyqi**, Mësimdhënëse për lëndën Prodhim Shtazor.
- **Prof. Asoc. Dr. Mirvjena Këllezi**, Mësimdhënëse për lëndët: Silvikultura 2 dhe Mbrojtja e Pyjeve nga Zjarret.
- **Prof. Ass. Dr. Fadil Musa**, Mësimdhënëse për lëndën Patologjia e Pyjeve,
- **Prof. Ass. Dr. Kushtrim Braha**, Mësimdhënëse për lëndët: Bazat e Ekonomisë dhe Bazat e Marketingut.
- **Prof. Ass. Dr. Sadik Maloku**, Mësimdhënëse për lëndën Ekonomia Bujqësore.
- **Prof. Ass. Dr. Bekim Gashi**, Mësimdhënëse për lëndë zgjedhore në programin e Shkencave të Pyjeve.
-

b). Asistentët:

- **Msc. Krenare Salihu**, Asistente për lëndë nga lëmia e Shkencave të Pyjeve.
- **Msc. Ergin Hajredini**, Asistent për lëndë nga lëmia e Shkencave të Pyjeve.

III. Kontratat e punës të personelit të përzgjedhur sipas këtij vendimi, do të lidhen nga rektori i Universitetit pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton që kandidatët e lartshënuar i plotësojnë më së miri kriteret ligjore të parapara në konkursin 01-19/A.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të sipërshënuara, dhe marrëveshjet që kemi me Universitetet tjera publike në Kosovë dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës për shkëmbimin e stafit akademik ndërmjet Universiteteve, përparësi kanë pasur mësimdhënësit e lartcekur për faktin se gjatë fazës së përpilimit të kurrikulës për këtë Fakultet kanë ndihmuar në përpilimin e syllabuseve për lëndët përkatëse dhe kanë nënshkruar deklaratën për angazhim në mësimdhënie për lëndët përkatëse sipas kërkesave të Agjencisë për Akreditimin të Kosovës.

Po ashtu, gjatë përzgjedhjes së kandidatëve së lartcekur, kriteri kryesor për renditjen në listën e lartcekur ishte grada akademike dhe fushën specifike e studimeve.


Vlen të theksohet se përzgjedhja e ligjërueseve të gjuhës angleze është bërë për faktin se kandidatet tjerë aplikant, ndonëse kanë pasur grada akademike më të larta se kandidatet e përzgjedhura, të njëjtit nuk i kanë plotësuar kriteret e parapara në konkursin 01-19/A pasi që dokumentacioni i tyre ka qenë i pa kompletuar.

Prandaj mbi këtë bazë, Këshilli i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim Juridike: Për afatin dhe procedurën e ankesës shih konkursin nr. 01- 19/A datë 28.01.2019.

Kryesues i Këshillit të Fakultetit

Prof. asoc. dr. Isuf Lushi



Vendimi i dërgohet:

Këshillit të Fakultetit
Të përmendurve
Zyrës së Personelit
Arkivit